



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1026/3 Prot

Tiranë, më 23/08 2013

REKOMANDIM

Nr. 19 datë 2 / 08 / 2013

Mbështetur në ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr. 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit “Klinika Dentare *KISSDENT*” Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 148 datë 15.08.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “Klinika Dentare *KISSDENT*” me adresë, Rruga Lidhja e Prizrenit, pranë Tirana Bank (prapa Akademisë së Arteve) Tiranë. Ky kontroll administrativ u fillua kryesisht nga Komisioneri.

Objekti i Kontrollit administrativ ishte:

- Plotësimi i formularit të njoftimit (neni 21).
- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale të pacientëve dhe ruajtjen e konfidencialitetit (neni 27, 28).

Grupi i kontrollit administrativ:

- Intervistoi dhe mori deklarime nga përfaqësuesja e kontrolluesit.
- Inspektoi ambientet e punës të këtij kontrolluesi.

Gjatë kontrollit administrativ përfaqësuesit kontrolluesit u treguan bashkëpunues dhe vendosën në dispozicion të grupit të kontrollit të gjitha materialet dhe dokumentat e kërkuara.

Kontrolluesi “Klinika Dentare *KISSDENT*” kryen aktivitetin e tij në fushën e stomatologjisë (shëndetit dentar) dhe gjatë këtij aktiviteti mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë klientë (ose pacientë).

Për kategorinë “klientë” gjatë aktivitetit të tij kontrolluesi mbledh të dhëna personale si emri, mbiemri, data e lindjes, gjinia, moshë, numri i telefonit, diagnoza, të dhëna mbi alergjitë e mundshme, grafi të dhëmbëve dhe fotografi. Këto të dhëna mblidhen nga personeli i mjekëve përmes plotësimit elektronik të kartelës së klientit nëpërmjet një sistemi elektronik profesional për fushën e stomatologjisë.

Të dhënat personale të klientëve nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin për të cilat ato mblidhen dhe përpunohen. Qëllimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale për klientët është vetëm ofrimi i shërbimeve në fushën e stomatologjisë.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se të dhënat lidhur me “fotografitë e klientëve” e tejkalojnë qëllimin e përpunimit dhe mund të konsiderohen si të tepërta. Ato mund të përpunohen vetëm nëse klienti ka dhënë pëlqimin paraprak në formë shkresore.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se të dhënat personale të klientëve nuk duhet të mbahen për një afat të pacaktuar. Kjo bie në kundërshtim me shkronjën d) të pikës 1 të nenit 5 të ligjit, në të cilin theksohet fakti se të dhënat personale nuk duhet të mbahen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar. Në këtë rast duhet të respektohen afatet e parashikuara në kreun III “Ruajtja e të dhënave shëndetësore” të Udhëzimit nr. 23, datë 20.11.2012 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”.

Sa i përket programin “X-View dental system” për regjistrimin e klientëve, konstatohet se nuk ka akses të kufizuar nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimin përkatës, të personalizuar për administratorin dhe për çdo punonjës.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson angazhimin dhe përpjekjet e kontrolluesit në kuadër të plotësimit të detyrimit për njoftim, ruajtjes së konfidencialitetit dhe marrjen e pëlqimit paraprak të klientëve për përpunimin e të dhënave të tyre personale.

Gjithashtu, në parim, është për tu vlerësuar fakti i hartimit të rregullores së brendshme (në kuadër të zbatimit të nenit 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”), por konstatohet se ajo duhet të jetë më e plotë dhe të parashikojë masa konkrete sigurie, detyrimet e kontrolluesit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Ç’do përdorues i Sistemit elektronik për regjistrimin e klientëve të Klinikës, të aksesojë të dhënat në mënyrë të kufizuar vetëm nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit përkatës të personalizuar.

2. Të dhënat personale nuk duhet të mbahen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar. Të respektohen afatet e parashikuara në kreun III "Ruajtja e të dhënave shëndetësore" të Udhëzimit nr. 23, datë 20.11.2012 "Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë".
3. Rregullorja e brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave të jetë më e plotë duke parashikuar masa konkrete sigurie, detyrimet e kontrolluesit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave. (Të merret si shembull rregullorja tip e publikuar në faqen zyrtare www.kmdp.al)
4. Të dhënat lidhur me "fotografitë e klientëve" e tejkalojnë qëllimin e përpunimit dhe konsiderohen si të tepërta. Ato mund të përpunohen vetëm nëse klienti ka dhënë pëlqimin paraprak në formë shkresore, në të kundërt ato duhet të fshihen.
5. Këto detyrimeve të rëndësishme që ju ngarkon ligji, të kryhen brenda një afati kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e marrjes dijeni për këtë rekomandim;
6. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
7. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", sipas të cilit: "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

